

BULETIN JAVOR

7-11 GUSHT 2023



Shprehja

"Siguria është gjithmonë e tepruar derisa nuk mjafton."

Robbie Sinclair

e javës

Përmbajtja:

- CISA paralajmëron organizatat për dobësi të shfrytëzuara që prekin .NET, Visual Studio
- Intel adreson 80 vulnerabilitete që prekin produktet e saj
- Ekspozohen të dhënat e votuesve në Mbretërinë e Bashkuar
- Microsoft - Patching Alert



CISA paralajmëron organizatat për dobësi të shfrytëzuara që prekin .NET, Visual Studio

Agjencia e SHBA-së për Sigurinë Kibernetike dhe Sigurinë e Infrastrukturës (CISA) ka shtuar një defekt *zero-day* që prek produktet .NET dhe Visual Studio të Microsoft-it në Katalogun e Vulnerabiliteteve të Njohura.

Vulnerabiliteti, e gjurmuar si CVE-2023-38180, u rregullua nga Microsoft me përditësimet e saj të *Patch Tuesday* në gusht 2023, e cila adreson gjithashtu CVE-2023-36884, një vulenrabilitet e Office e shfrytëzuar nga aktorët rusë të kërcënimit.

Microsoft zbulon se shfrytëzimi në distancë është i mundur dhe nuk kërkohet ndërveprim me përdoruesit.

Katalogu i CISA-s përfshin gjithashtu disa vulnerabilitete të tjera të shfrytëzuara që prekin .NET dhe/ose Visual Studio.

[Link:Lexo më shumë](#)



Intel adreson 80 vulnerabilitete që prekin produktet e saj

Intel së fundmi lëshoi gjithsej 46 këshilla të reja sigurie për të informuar klientët për 80 vulnerabilitete që prekin firmuerin dhe softuerin e kompanisë.

Vulnerabilitetet më serioze, bazuar në rezultatin e tyre CVSS, janë 18 çështje me ashpërsi të lartë që lejojnë përshkallëzimin e privilegjeve ose, në disa raste, sulmet e mohimit të shërbimit (DoS).

Këto kryesisht lejojnë një sulmues lokal të përshkallëzojë privilegjet, dhe disa mund të çojnë në zbulimin e informacionit ose sulme DoS.

Shumica e këtyre vulnerabiliteteve të zbuluara kanë marrë *patche*, por disa nga produktet e prekura janë ndërprerë.

[Link:Lexo më shumë](#)



Të dhënat e votuesve në Mbretërinë e Bashkuar ekspozohen në sulmin kibernetik të Komisionit Zgjedhor

Komisioni Zgjedhor i Mbretërisë së Bashkuar ka zbuluar se ka qenë viktimë e një "sulmi kompleks kibernetik", duke ekspozuar të dhënat personale të miliona votuesve britanikë. Aktorët keqdashës arritën në "kopje referimi" të regjistrave zgjedhorë, të mbajtur nga Komisioni për qëllime kërkimore dhe për të mundësuar kontrollet e lejueshmërisë së donacioneve politike. Kjo përmbante të dhëna personale të kujtudo në MB që ishte regjistruar për të votuar midis 2014 dhe 2022, duke përfshirë emrat dhe adresat e shtëpisë. U ekspozuan edhe emrat e të regjistruarve si votues jashtë shtetit.

Aktualisht nuk ka asnjë tregues se kush mund të ketë qenë pas shkeljes.

[Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Microsoft lançon patche për 74 vulnerabilitete të reja në përditësimin e muajit Gusht.

Microsoft ka korrigjuar gjithsej 74 vulnerabilitete në softuerin e tij si pjesë e përditësimeve të kompanisë për muajin gusht 2023.

Kjo përfshin gjashtë vulnerabilitete kritike, 67 të rëndësishme dhe një vulnerabilitet me ashpërsi të moderuar. Lëshuar së bashku me përmirësimet e sigurisë janë edhe dy raporte me përditësime të thella (ADV230003) dhe (ADV230004).

Microsoft njoftoi se instalimi i përditësimit më të fundit "ndalon zinxhirin e sulmit" që çon në gabimin e ekzekutimit të kodit remote.

[Link:Lexo më shumë](#)